

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË

Nr. 4814 Rep.
Nr. 336 Kol. 14

KONTRATË SHITBLERJE KUOTASH

Sot më datë, 24.12.2018, përpara meje Loriana A. Robo, anëtar i Dhomës së Noterëve Tiranë, me adresë në Tiranë, Rr. "Ismail Qemali", nr. 27/1, u paraqitën palët e mëposhtme për të nënshkruar këtë marrëveshje ("Kontrata"):



Arta Gurabardhi, e lindur në Tiranë, me 20 shtator 1977, me nr. personal identifikimi H75920138M, me adresë email agurabardhi@abkons.com dhe me adresë në Bulevardi 'Bajram Curri', Pall.6, Shk.1, Ap. 9, Tiranë ("Shitësi")

dhe

Besnik Leskaj, i lindur në Tiranë, me 30 qershor 1976, me nr. personal identifikimi H60630112W, me adresë email leskajb@abkons.com dhe me adresë pranë zyrave të Bulevardi 'Bajram Curri', Pall.6, Shk.1, Ap. 10, Tiranë ("Blerësi"),

të gjithë madhorë dhe me zotësi të plotë për të vepruar,

(në vijim Shitësi dhe Blerësi do të përcaktohen bashkërisht si "Palët" dhe veçmas si "Pala").

Kushtet paraprake

- (A) Në datën e kësaj Kontrate, Shitësi dhe Blerësi kanë nënshkruar një marrëveshje kuadër që rregullon marrëdhëniet e tyre në shoqëritë tregtare ku janë aktualisht bashkë-ortakë dhe, ndër të tjera, në shoqërinë Albanian Financial Institution SHPK, me seli ligjore në Tiranë, Njësia Bashkiake n. 2, Rr. Themistokli Gërmenji, përballë TVSH, K II, me kapital 266,260,000 ALL dhe NUIS L52327028M (në vijim "Shoqëria");
- (B) Shitësi është aktualisht pronar i një kuotë me vlerë nominale të barabartë me 53,252,000 ALL që përfaqëson 20% të kapitalit të Shoqërisë ("Kuota Target");
- (C) Blerësi është aktualisht pronar i një kuote të Shoqërisë me vlerë nominale të barabartë me 157,756,000 ALL që përfaqëson 60% të kapitalit të saj;
- (D) Shitësi, bazuar në kontratën e huasë të datës 1 shkurt 2017, të ndryshuar nga shtojca n.1 dhe shtojca n.2, i ka dhënë Shoqërisë AFI një hua ortakë me vlerë të përgjithshme (principal plus interesa të maturuara deri në datën 31 janar 2019) të barabartë me 145,905.30 (njëqind e dyzetë e pesë mijë, e nëntëqind e pesë pikë tridhjetë) Euro ("Hua Ortaku").
- (E) Shitësi ka si qëllim t'i shesë Blerësit Kuotën Target dhe Blerësi ka si qëllim të blejë Kuotën Target nga Shitësi sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në vijim.

Palët, duke marrë parasysh sa më sipër, bien dakord si në vijim:

Neni 1
Kushtet paraprake

1.1 Kushtet paraprake të mësipërme janë pjesë thelbësore dhe integruese e kësaj Kontrate.

1

Neni 2
Kushti i Kontratës

- 2.1 Palët bien shprehimisht dakord se detyrimi i Shitësit për t'i transferuar pronësinë e Kuotës Target Blerësit hyn në fuqi vetëm pasi Shoqëria t'i ketë ripaguar Shitësit Huanë e Ortakut në shumën 145,905.30 Euro, dhe pas pagimit të Çmimit të Kuotës Target të përcaktuar në pikën 3.1 të kësaj Kontrate.

Neni 3
Shitja e Kuotës Target

- 3.1 Nëpërmjet kësaj Kontrate dhe në përputhje me kushtet dhe afatet e parashikuara në të, Shitësi i shet dhe i transferon Blerësit i cili, pranon dhe blen, Kuotën Target me një çmim të barabartë me Lekë 53.252.000 (pesëdhjetëetë milion e dyqind e pesëdhjetë e dy mijë) (në vijim referuar si "Çmimi").
- 3.2 Çmimi do të paguhet nga Blerësi në llogarinë bankare të Shitësit brenda datës 31 janar 2019.
- 3.3 Pa kundërshtuar klauzolat përkatëse të kësaj Kontrate, Palët bien shprehimisht dakord se titulli i pronësisë mbi Kuotën Target do të transferohet nga Shitësi tek Blerësi pasi Blerësi t'i ketë paguar Shitësit Çmimin e Kuotës Target sipas pikës 3.1 më sipër, dhe pas pagimit të Huasë së Ortakut në shumën 145,905.30 Euro.
- 3.4 Për më shumë qartësi, Palët deklarojnë se, nëse brenda afatit të parashikuar në nenin 3.2 më sipër, (a) Shoqëria nuk i ka ripaguar Shitësit Huanë e Ortakut, dhe/ose (b) Blerësi nuk i ripaguan Shitësit Çmimin e Kuotës Target, Kontrata do të zgjidhet dhe, si rrjedhim, nuk do të prodhojë asnjë efekt ligjor në lidhje me transferimin e titullit të pronësisë së Kuotës Target nga Shitësi tek Blerësi.
- 3.5 Me qëllim regjistrimin e kësaj Kontrate pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ("QKB"), Palët bien dakord dhe pranojnë se do të jetë e mjaftueshme të depozitohet në QKB (a) mandati bankar që vërteton pagesën e Çmimit të Kuotës Target dhe të Huasë së Ortakut në favor të Shitësit ose (b) një deklaratë e lëshuar me shkrim nga Shitësi ku ky i fundit pranon se i është paguar Çmimi i Kuotës Target dhe Huaja e Ortakut.

Neni 4
Deklarime dhe Garanci të Shitësit

- 4.1 Shitësi deklaron dhe garanton se është i vetmi pronar dhe titullar i Kuotës Target dhe të drejtave që rrjedhin prej kësaj Kuote Target.
- 4.2 Shitësi deklaron dhe garanton se Kuota Target është tërësisht e lirë nga çdo peng, privilegj, barrë siguroese, detyrim, garanci apo çdo e drejtë tjetër në favor të të tretëve.
- 4.3 Shitësi deklaron dhe pranon se, pas shlyerjes së Huasë së Ortakut, Shoqëria nuk do të ketë asnjë detyrim financiar kundrejt tij.

Neni 5
Deklarime dhe Garanci të Blerësit

- 5.1 Blerësi deklaron se për sa kohë Shitësi ka qënë (i) e emëruar zyrtarisht në cilësinë e administratores së Shoqërisë ose (ii) ortake e saj, nuk do të jetë subjekt i asnjë përgjegjësie të asnjë lloji, forme apo natyre, ndaj Shoqërisë apo ortakëve të saj dhe/apo padi regresi për shkak të detyrimeve kërkuar këtyre të fundit nga palët e treta.

Neni 6
Të ndryshme

- 6.1 Llogaria bankare e Shitësit ku do të bëhen të gjitha pagesat e parashikuara në këtë Kontratë është si më poshtë:
Mbajtës i Llogarisë Bankare: Arta Gurabardhi
Banka: Intesa Sanpaolo Bank Albania
Nr. i Llogarisë Bankare: 41829535102 EUR
- 6.2 Të gjitha njoftimet, kërkesat dhe komunikimet e tjera ndërmjet Palëve duhet të bëhen me shkrim dhe të dorëzohen në adresat përkatëse të Blerësit dhe të Shitësit, nëpërmjet letrës rekomande me kthim përgjigje ose postë elektronike.
- 6.3 Çdo njoftim do të jetë i vlefshëm vetëm nëse verifikohen kushtet e mëposhtme: a) nëse është dërguar me postë elektronike, në momentin në të cilin është marrë posta elektronike; b) nëse është dërguar me letër rekomande, në datën e dorëzimit tek marrësi që do të vërtetohet me fletën e kthimit.
- 6.4 Në rast të mungesës së parashikimeve në këtë Kontratë dhe/apo kundershtie midis klauzolave të Marrveshjes Kuadër me këtë Kontratë, mbizotërojnë klauzolat përkatëse të Marrëveshjes Kuadër.
- 6.5 Shpenzimet notariale për lidhjen e Kontratës do të ndahen në mënyrë të barabartë midis Palëve.

Neni 7
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 7.1 Palët angazhohen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje që lidhet me interpretimin dhe ekzekutimin e kësaj Kontrate. Nëse një zgjidhje e tillë nuk është e mundur, mosmarrëveshja do të zgjidhet eskuzivisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 8
E drejta e zbatueshme

- 8.1 Kjo Kontratë dhe të drejtat e detyrimet e Palëve do të rregullohen në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 9
Vlefshmëria – Kopjet origjinale

- 9.1 Kjo Kontratë bëhet e vlefshme me nënshkrimin e saj nga Palët. Kjo Kontratë hartohet në 8 (tetë) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Kjo Kontrate pasi u njoh prej meje Noteres Loriana A. Robo, iu lexua Palëve të cilët e dëgjuan dhe miratuan me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë. Akti nënshkruhet nga Palët në praninë time dhe unë Noterja e vërtetoj në bazë të ligjit.

SHITËSI

Arta Gurabardhi
Arta Gurabardhi

BLERËSI

Besnik Leskaj
Besnik Leskaj

NOTER
Loriana A. Robo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	L52327028M
2. Data e Regjistrimit	27/11/2015
3. Emri i Subjektit	ALBANIAN FINANCIAL INSTITUTION
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	23/11/2015
6. Kohëzgjatja	Nga: 23/11/2015
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake Nr. 2, Rruga Themistokli Gërmenji, Pallati perballe RTSH, Kati 1
8. Kapitali	266.260.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	3,00
9. Objekti i aktivitetit	<p>Ushtrimi i aktivitetit të faktoringut si dhe aktiviteteve të tjera financiare jo-bankare, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar duke përfshirë dhenien e shërbimeve këshilluese, ndërmjetese dhe shërbime të tjera ndihmese për aktivitetin kryesor. Shoqëria mund të themelojë, zotërojë pjesëmarrje a kontrollojë shoqëri të tjera tregtare, apo të bashkëpunojë, të lidhë marrëveshje joint-venture a marrëveshje të ngjashme, me shoqëri të tjera që kanë objekt të njëjtë apo të ngjashëm me objektin e Shoqërisë si dhe mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë çdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj. Shoqëria mund të kryejë transaksione financiare, transaksione me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme si dhe të garantojë detyrimet e veta apo të paleve të treta duke vendosur mbi pasuritë e saj garanci të ndryshme sipas parashikimeve ligjore. Të gjitha format e kredidhenies, faktoringu, qira financiare, ofrimi i garancive dhe marrja e angazhimeve,</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	sherbime keshilluese, ndermjetese dhe sherbime te tjera ndihmese per te gjitha veprimtarite e shoqerise.	
10. Administratori/ët	Elona Telha	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 29/10/2018	Deri: 29/10/2023
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Eksperti/ët Kontabël (nëse ka)	MAZARS	
12.1 Afati i emërimit	Nga: 27/08/2018	Deri:
13. Ortakët	RedjanBasha	
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 53.252.000,00	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve	1,00	
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	20,00	
<i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i>		
14. Ortakët	BesnikLeskaj	
14.1 Vlera e kapitalit	Para: 159.756.000,00	Natyre:
14.2 Numri i pjesëve	1,00	
14.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	60,00	
<i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i>		
15. Ortakët	ArtaGurabardhi	
15.1 Vlera e kapitalit	Para: 53.252.000,00	Natyre:
15.2 Numri i pjesëve	1,00	
15.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	20,00	
<i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i>		
16. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
17. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: ALBANIAN FINANCIAL INSTITUTION E-Mail: info@afinstitution.com Telefon: 0035544325360	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

18. Statusi:	Aktiv
--------------	-------

Datë: 24/12/2018

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)



Kopje nga WEB

VENDIM I ASAMBLESË SË ORTAKËVE

TË

SHOQËRISË “ALBANIAN FINANCIAL INSTITUTION” SHPK

Në Tiranë, më 24 Dhjetor 2018, ortakët e shoqërisë “ALBANIAN FINANCIAL INSTITUTION” SHPK, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar dhe që ekziston sipas të drejtës shqiptare, e regjistruar në Regjistrin Tregtar me NUIS L52327028M (“Shoqëria”), pa formalitetin e thirrjes së mbledhjes, duke pasur kuorumin dhe shumicën e duhur për marrjen e vendimeve, thirret mbledhja e jashtëzakonshme e Asamblesë së Ortakëve lidhur me transferimin e kuotës të Ortakut Zj. Arta Gurabardhi, në përputhje me parashikimet përkatëse të Statutit të Shoqërisë dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare nr.9901.

Të pranishëm në mbledhje janë:

Zj. Arta Gurabardhi, shtetase shqiptare, e bija e Xhemilit, lindur më 20 shtator 1977 në Tiranë, dhe banuese në Tiranë, në adresën Bulevardi ‘Bajram Curri’, Pall 6, Shk 1, Ap. 9, mbajtëse e kartës së identitetit me nr. personal H75920138M, në cilësinë e Ortakut të Shoqërisë, zotëruese e 20% të kapitalit të Shoqërisë;

Z. Redjan Basha, shtetas shqiptar, i biri i Nylbiut, lindur më datë 08 mars 1984 në Gjirokastrë, dhe banues në Tiranë, në adresën Ruga Blv. ‘Gjergj Fishta’, Kulla nr.5, Kati 13, Ap.65, Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me nr. personal I40308092C, në cilësinë e Ortakut të Shoqërisë, zotërues i 20 % të kapitalit të Shoqërisë; dhe

Z. Besnik Leskaj, shtetas shqiptar, i biri i Astritit, lindur më datë 30 Qershor 1976 dhe banues në Tiranë, në adresën Rruga Blv. ‘Bajram Curri’, Pallati nr.6, Shk.1, Ap.10, mbajtës i kartës së identitetit me nr. personal H60630112W në cilësinë e Ortakut të Shoqërisë, zotërues i 60% të kapitalit të Shoqërisë;


të cilët organizojnë këtë mbledhje me rendin e ditës:

- (i) për të miratuar kalimin e Kuotës përkatëse të Shoqërisë AFI SHPK nga Zj. Arta Gurabardhi tek Ortaku Z. Besnik Leskaj.

Ortakët e AFI SHPK, duke qënë se keta ortakë ekzistues të kësaj Shoqërie e konsiderojnë të shteruar të drejtën e parablerjes tek ortaku tjetër jo blerës, si dhe përmbushjen e të gjitha kërkesave përkatëse të statutit dhe ligjit, vendosin sa më poshtë në lidhje me transferimin e Kuotës së Ortakut Arta Gurabardhi në favor të Ortakut Besnik Leskaj:

VENDOSIN

1. Të miratojnë transferimin e të gjithë kuotës të zotëruar nga Ortaku Arta Gurabardhi që përfaqëson 20 % të kapitalit të Shoqërisë tek Ortaku Besnik Leskaj, sipas Marrveshjes Kuadër dhe Kontratës së Transferimit perkatëse, dhe kundrejt shpërblimit të përcaktuar në këto marrveshje, që lidhen mes palëve për këtë qëllim. Ortakët e Asamblesë bien dakord pa asnjë rezervë të miratojnë kalimin e titullit të kuotës nga Arta Gurabardhi tek Besnik Leskaj.
2. Pas transferimit kundrejt shpërblimit të Kuotës së Arta Gurabardhi, struktura e kapitalit të Shoqërisë do të jetë si më poshtë:



- i. Z. Besnik Leskaj 80 %
- ii. Z. Redjan Basha 20 %.


3. Shoqëria dhe/ose Ortakët e saj, nuk do të kenë më asnjë pretendim dhe/ose nuk do të ngrenë asnjë padi ndaj Arta Gurabardhi, si në cilësinë e Ortakut transferues, po ashtu dhe të Administratorit të Shoqërisë. . Po kështu, nga Shoqëria dhe/ose Ortakët e saj nuk do t'i kundërdrejtohen Shitësit Arta Gurabardhi, as në cilësinë e Ortakut dhe as në cilësinë e Administratorit, me ndonjë padi regresi në lidhje me një çështje të nisur nga Shoqëria, Ortakët e saj, dhe/ose nga palë të treta.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Duke mos pasur çështje të tjera për të vendosur, ky Vendim nënshkruhet rregullisht nga ortakët e "ALBANIAN FINANCIAL INSTITUTION" SHPK.

ORTAKËT E "ALBANIAN FINANCIAL INSTITUTION" SHPK


Znj. Arta Gurabardhi



Z. Besnik Leskaj




Z. Redjan Basha



Në dëshmi të sa më sipër

Administratori i Shoqërisë



Elona Telha

